

Haxhi (Misin) Seferaj

(11.07.1940, egjiptian nga Hereç/Ereç, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, katër fëmijë)

Haxhiu jetonte në Hereç/Ereç me djalin Kujtimin dhe të rejën. Djali me shoqen shkuan te farefisi në fshatin Treboviq/Trebović, në fund të muajit prill të vitit 1998. Në datën **12.05.1998**, Haxhiu ka shkuar për t'i marr ata. Në kthim e sipër, në fshatin Strellc/Streoc, ata u ndalën nga policia serbe. Nga autobusi e nxorën Kujtimin dhe një djalë të ri dhe i rrahën keq. Më pas, u lejuan që të ktheheshin në autobus. Nga frika se policia do të mund ta ndalte sërish autobusin, Kujtimi vendosi të vazhdonte udhëtimin më këmbë drejt Hereçit/Ereç, ndërkaq Haxhiu dhe e reja vazhduan tutje me autobus. Nga droja për fatin e djalit, i cili u nis më këmbë, Haxhiu kishte dal nga autobusi në **Prilep/Prilep**, ku deshë ta prishte të birin. Nga ajo ditë nuk dihet asgjë për fatin e Haxhiut. Familja e ka paraqitur zhdukjen e tij në KNKK. Në muajin shtator të vitit 1998, gjatë ekspozimit të rrobave të kufomave të gjetura në kanalën e **Liqenit të Radoniqit/Radonjičko jezero**, i cili ishte bërë në hotelin *Pashtrik*, në Gjakovë/Đakovica, Kujtimi dhe e ëma i kanë identifikuar rrobat e Haxhiut. Po atë ditë, autoritetet serbe u kanë dorëzuar mbetjet mortore për të cilat pohonin se u takonin Haxhiut. Po atë ditë, u bë varrimi i Haxhiut në vendlindjen e tij në fshatin Plançor/Pljančor të Gjakovës/Đakovica. Pas vitit 2005, është bërë zhvarrimi i mbetjeve mortore për të cilat thuhej se ishin të Haxhiut dhe u krye identifikimi i tyre përmes analizës ADN. U konstatua se ato nuk i takojnë Haxhiut. Familja është ende në kërkim e sipër të mbetjeve të tij mortore.

Burimet: deklarata K.S, FDH-20557; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KMKRF], *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 902; ICTY, IT-04-84 (R.Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 03.04.2008, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-\(-IT-04-84-\);](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-(-IT-04-84-);) ICTY, IT-04-84 (R.Haradinaj dhe të tjerë), aktakuza, 03.04.2008, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-\(-IT-04-84-\);](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-(-IT-04-84-);)

Rexhë (Selman) Pajazitaj

(20.03.1933, shqiptar nga Isniqi/Istinić, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, gjashtë fëmijë)

Diku nga ora 12:00 të datës **19.05.1998**, Rexha ka shkuar në fushë ku për ditë e çonte bagëtinë në kullotë. Donte ta riparonte gardhin. Bashkëshortja dhe fëmijët e prisnin tërë ditën, por ai nuk u kthye atë ditë. Të nesërmen në mëngjes, Naz Osdautaj, i cili e ka shtëpinë në afërsi të fushës së familjes Pajazitaj, i ka lajmëruar familjarët se Rexhën e kishin vrarë dhe se kufoma e tij gjendet në vendin e quajtur *Podi i Osdautëve* [Isniq/Istinić]. Po atë ditë, vëllai i Rexhës dhe farefisi shkuan për të marrë kufomën e tij. Konstatuan se Rexhën e kishin vrarë me një plumb në ballë. Po atë ditë [20.05.1999], e kanë varrosur në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata A.P. FDH-17056; KMDLNI, *Buletini*, num.7, prill-qershor 1998, 160, FDH-23816; deklarata NN, FDH-12277; deklarata NN, FDH-12095.

Bajram (Osë) Osdautaj

(1932, shqiptar nga Isniqi/Istinić, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, pesë fëmijë)

Bajrami me familje kanë kaluar më 10.05.1998 në shtëpinë e të vëllait, i cili, po ashtu, jetonte në **Isniq/Istinić**. Në datën **19.05.1998**, ai i ka thënë familjes së po shkonte ta vizitonte shtëpinë dhe kontrollonte bagëtinë. Ka qenë kjo ditë kur familjarët e kanë parë të gjallë për herë të fundit. Pas dy ditësh, i vëllai Sadriu dhe djemtë Lahu dhe Milazimi e kanë gjetur trupin e Bajramit në një pyll, afro 150 metra larg shtëpisë. Ishte qëlluar me plumba në kokë. Po atë ditë [21.05.1998], familjarët e kanë varrosur atë në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata M.O, FDH-17060; deklarata NN, FDH-12277; KMDLNI, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 160, FDH-23816; deklarata NN, FDH-12095.

Rade (Aleksandar) Popadić

(15.08.1956, serb nga Shabaci, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)